



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr.71, datë 18.04.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE TË SUBJEKTIT ARRSH “AUTORITETI
RRUGOR SHQIPTARË” PËR VEPRIMTARI TË TJERA NË BRIGJET DHE
SHTRATIN E BURIMIT UJOR ME QËLLIM ZGJERIMIN E URËS SË LANËS, E
POZICIONUAR NË PROGRESIVËN 2+259 NË PROJEKTIN E ZGJERIMIT TË
AUTOSTRADËS TIRANË-DURRËS, LOT-I, FAZA-I, NË BASHKINË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 3, gërma (a), nenit 141, pika 3 dhe nenit 156, pika 2 të ligjit Nr.29/20242, “Për burimet ujore”, Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të subjektit ARRSH “Autoriteti Rrugor Shqiptar” për veprimtari të tjera në brigjet dhe shtratin e burimit ujor me qëllim zgjerimin e Urës së Lanës, e pozicionuar në progresivën 2+259 në projektin e zgjerimit të autostradës Tiranë-Durrës, Loti-I, Faza-I, në Bashkinë Tiranë.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Lumi Lana.

IKAESHO
DETARITERR

IKES
SHI

Vendodhja e strukturës që do të ndërtohet (koordinatat KRRGJSH).

Ura në Lumin e Lanës

Pika 1- X= 478559.68 Y= 4579947.63 Z= 59 m.m.n.d
Pika 2- X= 478586.71 Y= 4579935.29 Z= 59 m.m.n.d
Pika 3- X= 478566.59 Y= 4579913.01 Z= 59 m.m.n.d
Pika 4- X= 478592.74 Y= 4579901.61 Z= 59 m.m.n.d

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: Zgjerimi i Urës në Lumin Lana në progresivën 2+259
në projektin: Zgjerimi i autostradës Tiranë-Durrës, Loti-I, Faza-I

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim pas nënshkrimit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

DREJTOR I AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

ANILA SHEHU

Nënshkruar më datë 28/05 / 2025